Vdekje fashizmit — Liri Popullit

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ
DIL DY HERE NE JAVE: T'EJTEN DHE TE DIELLEN
Redaksija: Prishtine Rruga Emin Duraku Nr. 1
PAJTIMET per 1 vit 192 din — 6 muej 96 — — 3 muej 48 —
Dorshkrimet nuk kthehen
Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 137 | PRISHTINE, e ejte 19 Gusht 1948 | Çmimi 2 dinarë

Fjalim'i shokut Tito ne mbledhjen e organizates se partis se divizionit te I-re proletar

Antaret e organizates se Partis te Divizionit te Ire Proletar me 10 gusht kane mbajte mbledhjen, ne te cilen shoku Tito, nji nga delegatet e kesaj organizate te Partis per Kongresin e Peste te PKJ-s, mbajti referatin mbi punen e Kongresit. Ne mbledhje mori pjese dhe shoku Ivan Krajaçiq, antar i KQ te PKJ-s, i cili kishte mbrrijte bashke me shokun Tito.

Ne sallen e stolisun solemnisht me flamuj, parolla dhe fotografija te Marksit, Engelsit, Ljenjinit, Stalinit dhe shokut Tito, antaret e organizates se Partis ne krye me pergjegjesin e vet te Partis e prifen shokun Tito me brohoritje entuzjaste. Pershendetjet e perzemerta dhe brohoritje Partis Komuniste te Jugosllavis, Komitetit Qendruer dhe Sekretarit te Pergjithshem te Partis shokut Tito kane zgjate disa minuta.

Mbasi mori fjalen shoku Tito i falenderoi antaret e Organizates se Partis se Divizionit te I-re Proletar per besimin qe ia kane dhane tue e zgjedhe per delegat te vetin, e mandej ne referatin e vet ma te gjate ndermjet te tjerave tha:

„Shoke dhe shoqe,

E kame ndie per detyre me ardhe tek ju mbas mbajtjes se Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, si nji nga delegatet te cilet i keni zgjedhe juve per ate Kongres. Une jam i bindun se ju keni ndigjue per Kongresin e Peste prej delegateve t'uej te tjere dhe per keto arsye une nuk do te hyj ne hollesinat ne punen e Kongresit te Partis s'one, sepse juve sigurisht jeni te njoftun me materjalin, qe jane rezultatet e Kongresit te Peste. Por me gjithe ate une kishem dashte, si delegat i juej, me iu thane disa fjale mbi randesin e Kongresit te Peste per Partin t'one dhe Vendin t'one, per nderiimin e socjalizmit ne Vendin to'ne.

Kongresi ka randesi te madhe per zhvillimin e matutjeshem dhe per perforcimin e Partis Komuniste te Jugosllavis — si ne pikpamje organizative ashtu edhe teoriko-politike. Prandaj tash do te kishte dobi shum te madhe per Partin t'one, sikur te gjithe delegatet, te cilet kane marre pjese e qe kane qene ma se 2300 — te transmetojne eksperiencen nga ky Kongres te gjithe antareve te Partis s'one, qe keta t'a studjojne hollesisht materjalin, ne te cilin asht ba permbledhja e se kaluemes se Partis s'one -sukseset t'ona, gabimet t'ona dhe mungesat t'ona ne te kaluemen, e ne te cilin jane caktue gjithashtu detyrat per punen e ardheshme te Partis s'one, per zhvillimin e saje te matutjeshme ne pikpamje organizative dhe teoriko-politike".

Mandej shoku Tito vuni ne dukje kushtet e randa te punes ilegale te Partis dhe edukimin teorik te kuadrave t'ona te Partis nen ato kushte gjate 20 vjeteve te kaluemë, dhe tue vue ne dukje randesin e madhe te Kongresit te Peste dhe ne kete drejtim tha:

„Per te paren here, qysh se egziston Partija e jone, neve kemi muejte ne ket Kongres — me gjithse kemi pase ne dispozicion nji periudhe shum te shkurte — qe te perpunojme teorikisht, dhe politikisht te pakten ne vijat kryesore dhe themelore, shum probleme dhe çashtje ne te cilat kemi hase, sidomos ne vitet e fundit, gjate luftes çlirimtare dhe tash gjate ndertimit te socializmit ne vendin t'one. Kam shprese se kemi muejte afersisht me i dhane themelin teorik t'asaj praktike t'one revolucionare. Kuptohet se, qofte larg, ne mund te konsiderojme qe kjo asht e mjaftueshme. Kjo mund te sherbeje vetem si drejtim ose si nxitje per antaret e Partis s'one, qe ta zhvillojme matutje, te mesohet ne ket realitet t'onin, dhe ta pasunojne ditunin e vet tue studjue ne menyre te palodhshme Marksin, Engelsin, Lenjinin e Stalinin. Neve, si me thane, edhe ma teper e kemi nxite hovin e antareve te Partis qe te zhvillohen ma teper teorikisht qe te punoje sejcili prej tyne veç e veç sa ma shum, qe shkollat t'ona te Partis dhe kurset ta çfrytzojne ne menyre te plote etj. krejt materijalin e Kongresit. Neve per te paren here ne Kongresin t'one e kemi dhane perpunimin teorik te punes s'one praktike edhe ketu qendron gjithashtu randesija e madhe e Kongresit te Peste (Pranim).

Tue theksue se asht i domosdoshem analizimi i hollsishem i mungesave ne punen e organizates s'one te Partis dhe t'antareve, per te cilat asht fole gjansisht ne Kongres, shoku Tito, ne lidhje me çashtjen e luftes frakcioniste ne te kaluemen, e theksoi nevojen e ruejtjes se bashkimit te forte ne Partin t'one, e cila sod asht, si avangarde e klases puntore, Parti udheheqese, ne vendin t'one.

„Partija e jone — tha ai — e ka rolin udheheqes ne krejt jeten shoqnore te vendit t'one dhe per keto arsye ne te duhet t'egzistoje pa tjeter edhe ma forte bashkimi monolit i mendimeve dhe bashkimi i veprimit. Qe te mos me keq-kuptoni ndokush, detyrohem t'ju them, shoke, se ketu nuk asht fjala per pengimin e kritikes dhe t'autokritikes. Jo, perkundrazi, Partija revolucionare, siç asht e jona edhe ma teper do te forcohet ne qofte se e zbaton ne menyre te drejte kritiken dhe autokritiken. Kjo nuk do te shkoje n. damin e bashkimit dhe te monolitetit te saj. Por atehere kur vendimi pranohet, kur Partija, d. m. th. shumica ta ket pranue nji vendim, pakica duhet me doemos t'i nenshtrohet dhe t'i zbatoje pa kondita ato vendime. Kjo asht demokracija e Partis, kjo asht centralizimi demokratik, kjo asht kondite per pune te shendoshe dhe jete te frytshme te nji Partije revolucionare sikurse asht kjo e jona".

Marshali i Jugosllavis Josip Broz - Tito

Mbi çashtjet e katundaris dhe gjoja rritjen e kapitalizmit tek ne, shoku Tito tha:

„Natyrisht, ne Kongres na asht dashte me doemos me thane kjartazi, ne perspektive, si e shiqojme na çashtjen katundare ne vendin t'one a e konsiderojme se asht e drejte shka thane ata te cilet na akuzojne ase kjo shka na mendojme qe duhet me punue. Na vete e kemi zgjedhe nji rruge, dhe ajo nuk asht nji shpikje e re e udheheqesave te Partis s'one, te Komitetit t'one Qendruer, por asht rezultat i njoftjes se zhvillimit te Revolucionit te madh te Tetorit dhe rezultateve te tij, te njoftjes se veshtiresinave te çashtjes katundare si ne periudhen e NEP-it ashtu ma vone, te njoftjes se veshtiresinave te cilat i ka pase Partija bolshevike. Na jemi perpjeke qe, tue i zgjidhe veshtiresinat, ta çfrytezojme eksperiencen e madhe te PK(b) te BRSS dhe t'i arrijme po te njajtat qellime sikur ajo.

Pastaj neve ne Kongres kemi thane se tash nuk mendojme me fillue nacionalizimin e tokes, sepse kjo do t'ishte vetem nji beklarate e cila praktikisht nuk do te thonte asgja, por e cila do te shkaktonte nder katundaret t'one nji turbullim dhe habije te madhe, e cila nuk na duhet.

Na kulakve ua kemi marre nji pjese te konsiderueshme te tokes, dhe sot ata nuk kane ma se 25—30 hektare toke. E neser, kur do te kemi mjaft mjete dhe t'i ndihmojme me makina dhe kredina kooperativat e punes dhe kooperativat tjera bujqesore qe te zhvillohen matutje, atehere do te jete rreziku gjithnji ma i vogel qe te pasunohen kulakat dhe shpekulantat tjere, sepse keto kooperativa do te prodhojne mjaft gjana ushqimore per nevojat e furnizimit te qytetareve. Kjo asht rruga e fitimit te socializmit ne katund".

Tue fole mbi çashtjen e ndertimit te socializmit ne Vendin t'one, shoku Tito nenvizoi se na, me gjithe veshtiresinat ne te cilat hasim, do t'a ndertojme socializmin tue pase parasyshe gjithnji qe standardi i jetes se njerzit t'one te rritet gjithnji. Ne lidhje me kete ai, ndermjet tjerave, tha:

„Na, shoke, ne Kongres e kemi analizue çashtjen — a mundemi me ndertue socializmin ne Vendin t'one: Kuptohet se mbas ksaj analize nuk ka mbet te kurkush as pak dyshim se a mundem me e ba kete pune. Mundemi. Natyrisht do te ishte gabim me mendue se neve kemi mendue ndonji here qe te shkojm ne socializem vetem, se nuk na intereson as Bashkimi Sovjetik as vendet e demokracis popullore, se duem te shkojm t'izoluem dhe se perpiqemi qe t'i mbyllim syte nga te gjitha anet e botes. Ju e dini fare mire besnikin e politikes s'one te jashtme. Ju e dini se, bash per faktin se kemi dashte me sigurue vendin t'one nga sulmi dhe kercnimi nga ana e fuqive imperialiste, kemi qene ata te cilet kemi dhane inicijative qe te realizohet dhe sigurohet bashkpunimi ekonomik ne mes te Bashkimit Sovjetik, te vendeve te demokracis popullore dhe te Jugosllavis, tue dijt se ajo asht rruga ma e lehte per ndertimin e socializmit ne vendin t'one. Pra, na kurr nuk kemi mendue me e realizue vetem socializmin. Shoke, une mendoj se vendi i jone ka dhane mjaft kontribut ne luften e madhe te kaluemë, se e ka tregue mjaft solidaritetin e vet ne ditet ma te veshtira si te Bashkimit Sovjetik ashtu edhe te popujve te tjere te robnuem. Na kurr nuk kemi muejte me mendue se ata sot munden me e vue ne rrezik kete bashkepunim me ne, na as nuk kemi mendue per kete gja. Por sot, nga Hungarija, Çekosllovakija, Polonija, Bullgarija dhe Rumunija na thone se na nuk mundemi me e ndertue socializmin, ne qofte se nuk na ndihmojne ata. Athue mundet nji komunist, athue munden njerzit udheheqes te nji vendi perparimtar me e shtrue keshtu çashtjen. Nuk duhet te shtrohet keshtu kjo çashtje. Na nuk e kemi meritue kete dhe kjo gja nuk mundet me na lekunde ne luften t'one per ndertimin e socializmit (pranim i gjate dhe frenetik).

Pastaj, shoku Tito mbi detyrat e komunistave n'ushtri, ne mes te tjerash, tha:

„Tash kishja me dashte me fole pak mbi detyrat e juve — komunistave n'ushtri. Asht e dijtun se socializmi nuk mundet me u-ndertue, ne qofte se nuk egziston Partija, Partija Komuniste qe ep drejtime, e cila i udheheq te gjitha. Pa Partin Komuniste, Partin e bashkueme, te forte dhe monolite nuk mundet me u-ndertue socializmi ne keto kushte, ne te cilat e ndertojme na sot socializmin. E, perveç kesaj, vendi i jone nuk asht aq i madh dhe nuk mundet me u-krahasue me Bashkimin Sovjetik. Ai ne kete pikpamje e ka pase ma lehte. Prandaj na duhet me e pase nji armate te forte, e cila ka me qene ruejtese vigjilante e ndertimit te socializmit ne vendin t'one. Ju, komunistat n'Armaten t'one, duhet te perpiqeni qe te jeni gjithkund te paret, qe Armata e jone gjithmone te ket mundesi me e ruejte vendin t'one prej lakmive ndaj liris dhe pamvarsis se saj. Duhet gjithmone te jeni te gatshem, sepse ne qofte se jeni gjithmone te gatshem — asnji anmik nuk mundet me guxue aq lehte me na sulmue.

Prandaj, asht e nevojshme — e kjo asht edhe detyre e juej — me i edukue kuadrat e reja, te cilat hyjne n'Armaten t'one. Njerzit e rij, te cilet punojne ne fushat dhe fabrikat t'ona do te vijne n'Armate. I mesoni dhe i ngritni politikisht. Sikurse asht Armata e jone shkolle, ne te cilen mesohet se si me i perdore sa ma mire mjetet moderne teknike ushtarake, gjithashtu, dhe me plot-kuptimin e fjales, ajo duhet me qene edhe shkolle politike e njerzve t'one, keshtu qe prej saj te dalin kuadra te reja te farkueme, antare te rij te Partis, te cilet ne çdo vend do te munden me punue me sukses.

Asht kujdes i juej qe Armata e jone t'i ushqeje traditat e luftes se kaluemë çlirimtare, domethane — vetdijen e nalte mbi pergjegjesin e çdo luftetari e njikohesisht me e çfrytzue eksperiencen e Armates se madhe Sovjetike, te cilen e ka mberrijte ajo gjate kesaj lufte. Por, edhe nji here po e theksoj, mos e harroni edhe eksperiencen t'one. Eksperienca e jone asht e pasun bash ne vetdijen e nalte te luftareve ne qendrueshmenin dhe ne vetmohimin, ne besimin e thelle te luftareve, si individ, ne fuqit e veta, qe e ban te pathyeshme nji Armate, e cila e mpron te drejten. E tille duhet te jete Armata e jone.

Ju, komunistat n'Armaten t'one duhet te keni jo vetem kurset, qerthullat dhe oret e jueja, por me iu spjegue situaten konkrete edhe atyne qe nuk jane antare te Partis dhe me diskutue me ta. Ju gjithmone do te jeni t'informuem me anen e ligjiruesve t'uej, do t'informoheni se çka ngjet ne vendin t'one, sepse ju duhet me e dijte kete, por atehere e trazmetoni kete edhe me masat jasht Partije. Spjegojuni te gjitha, spjegojuni se çka domethane socializem, spjegojuni se socializem domethane — me i çlirue njerzit definitivisht prej asaj qe njeriu ta shtype dhe çfrytzon njeriun dhe me e ba qe njerzit te jetojne me nji jete te denje per njerez, spjegojuni se socializem domethane jete e lumtun, e pasun dhe kulturale per çdo banor te vendit socialist.

Te rijt komunista duhet me dale nga Armata si luftare me vetdije te nalte per socializem.

Ju nuk jeni Armate e popullit vetem sepse i boni pushket dhe i rueni kufijt. Ju jeni Armate e popullit dhe ju duhet me pase qendrim te tille ndaj popullit per me e meritue ket thirrje. Ju duhet ne ket menyre me e edukue Armaten, qe ajo n'asnji moment te mos e humb lidhjen me popullin. Ajo per ket arsye thirret Armate e popullit, sepse me popullin ka lidhje te forte. Ajo nuk mundet me u-izolue nga populli, por duhet te jete Armate, e cila ne te gjitha vijat do te jete e lidhun ngusht me popullin".

Shoku Tito mandej vazhdoi:

„Pra, shoke, sikurse asht me randesi, qe na para mbare botes se ndershme, para mbare Partive komuniste, te tregojme se Partija e jone asht kompakte dhe monolite, se Par-

(Vazhdon ne faqen e 2-te)

Fjalim'i shokut Tito ne mbledhjen e organizates se partis se divizionit te I-re proletar

(Vijon nga faqja e 1-re)

tija e jone nuk do te kethen nga çoozitat e shkences merksiste-lenjiniste, — gjithashtu asht me randesi, qe mbare bota te bindet, se Armata e jone din jo vetem me i perdore armet me mjeshtri, se asht jo vetem Armate e fuqishme sulmuese, porse ajo asht e pjekun edhe politikisht, ne nji njesi te plote politike, kompakte dhe monolite, se askush nuk mundet me dyshue kurr ne kete Armate, se ajo per çfaredo qelle mund te lekundet, se ajo Armate asht gjithmone e gatshme me e krye çdo detyre, qe shtrohet para saj. Prandaj, ju komunista duhet te bahi t'alte qe kjo Armate te bahet e tille, sikurse kerkohet prej jush".

Mbi çashtjen e kritikes dhe t'autokritikes n'ushtri shoku Tito tha:

„Mos kujtoni qe na ne Kongres kemi fole nga shkaqet demagagjike qe kritika dhe autokritika jane arme me shum randesi per komunistat. Jo, kritika dhe autokritika asht nji prej armeve ma te randesishme dhe ma te forta per punen e drejte te komunistave, per pastertin e Partis, per monolitetin e saj dhe per zhvillimin e matutjeshem te saje. Te ju n'ushtri jane kushtet specifike dhe kjo çashtje e kritikes dhe e autokritikes te ju parashtrohet pak ma ndryshe se sa perjashta, n'organizatat e terrenit. Por, mos kujtoni se per shkak te ketij specificiteti n'Armate, ne te cilen egziston subordinacioni, kritika dhe autokritika nuk jane te mundshme. Ne mbledhjet e Partis duhet me ba kritike. Nenkuptohet se i ikei nuk munden me i kritikue gabimet profesionale me karakter ushtarak, kjo asht pune per udheheqesat ma te nalte. Por per te gjitha te tjerat, ne mbledhjet e Partis duhet me e kritikue vetvehten ai qe ka ba gabime. Keshtu, ne qofte se asht edhe udheheqes, ai nuk do ta humbe autoritetin e vet, sepse ai po e kritikon vetvehten para antareve te Partis. Kjo nuk do t'ja rrenoj autoritetin e tij, por bile do ta naltesoje. Mos frigohi kurr per me i pranue gabimet e jueja, po mos mendoni se asht mjaft me i pranue gabimet e pastaj me i perseritte prap me koshience. Ja, ne kete menyre kritikes i del boja dhe ky fare shoku e humbe autoritetin. Kete deshta me ju permende per shkak se asht parashtrue çashtja se a thue n'ushtri asht e mundun ne nji mase te plote kritika".

Shoku Tito e ka mbarue referatin e vet me keto fjale:

„Çdo komunist i ndershem, çdo njeri i ndershem qe e don vendin e vet, qe e don socializmin, qe asht besnik i ides se Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit nuk mundet me qene kunder vijes se Partis s'one kur t'ia spjegojsh. Asht e pamundun qe ai do t'iu besonte atyne qe shkruhen dhe qe çpifen kundra nesh: Ai, i cili ka mundesi qe edhe vet me e pa me vepra se kjo nuk asht e vertete e me gjithate flet dhe punon kunder vijes se Partis s'one, ai nuk asht i shendosh, ai ka ambicije te smunde, e per ate nuk ka vend ne Parti.

Shoke, kjo situate sod asht mjaft e veshtire, por na: — ne saje t'unitetit te Partis, ne saje te bashkimit te popujve te vendit t'one — do t'i perballojme edhe keto veshtiresina dhe do te provojme se kemi qene t'akuzuem padrejtesisht. Te kemi shprese ne fuqit t'ona te bindun se puna e drejte nuk mundet me deshtue. Na duhet te shkojme me guxim kah realizimi i detyreve t'ona, kah realizimi i qellimeve t'ona, kah realizimi i socializmit ne vendin t'one. Ketu nuk bahet fjale per kete ose per ate udheheqes, ketu asht fjala per socializmin ne vendin t'one, ketu bahet fjale qe na t'i tregojme mbare botes, domethane te gjithe miqeve t'one — se interesat e vendit t'one socialist nuk jane te ngushta, nacionaliste, sikurse na mveshet, porse njikohesisht keto jane pjese e interesave te njerzve te punes se mbare botes e keshtu ato interesa jane internacionaliste dhe perfaqesojne kontribut jo te vogel per fitoren e socializmit ne bote.

Le te rrnoje Partija komuniste e Jugosllavis.

Le te rrnoje Armata e jone e lavdishme".

Fundi i fjalimit te shokut Tito ka qene i percjellun me ovacione te gjata per Partin komuniste te Jugosllavis, per Komitetin Qendror, per shokun Tito, per unitetin e Partis s'one dhe per bashkimin e popujve t'one.

BLEMJA E DRITHNAVE TE BARDHE

Veshtirsit e para ne fushaten e blemjes se drithnave ne kete vjet jane tue u-perballue me sukses. Plani tashma asht perpune ne te gjitha rrethet, keshillat e vendeve dhe nder katunde. Sasina te mdhaja te drithnave po dorzohen per çdo dite ne magazinat e sipermarrjes shtetnore „Zhitopromet". Asht caktue norma e dites, e cila ne pjesen ma te madhe te rretheve asht tue u-realizue me sukses. Ne Podujeve realizohet norma e dites me 96 perqind, n'Istok 88,70 perqind, ne Peje 68 perqind, ne Rahovec 66 perqind, ne Drenice 65 perqind, ne Gjakove 62 perqind. Realizimin e planit te blemjes se drithnave jane tue e pengue kulaket, te cilet jane preke nga Dekreti i sivjem i blemjes se drithnave, sepse nuk kane muejt me i çfrytzue privilegjet n'ate mase sikur katundaret e mesem e te vobeget.

N'anen tjeter, shumica dermuese e katundaris punonjse i ka kontraktue te gjitha tepricat e veta. Plani i kontraktimit siç dihet asht plotsue afer 90 perqind. Te gjithe ata qe kane kontraktue perpara kane marre çmime ma te nalta dhe bonat perkatese per blemjen e artikujve industriale me çmime t'unjisueme ma t'ulta. Prandaj shumica e katundarve me plote deshire ia dorzojne drithin shtetit. Me ane t'organizatave te Frontit katundaret punuesa bajne presjon politik mbi kulaket, qe edhe keta t'i dorzojne sasinat e drithnave te veta shtetit populluer. Pra, çdo shkelje e Dekretit mbi plotsimin e blemjes se drithnave asht e denueshme, çka e provon nji numer i vogel i disa spekulantave, te cilat per shkak se jane perpjeke me e largue drithin jane denue me te holla.

Keshillat popullore, me gjithse i kane mposhte veshtirsinat kryesore duhet qe edhe ma tutje te punojne ngultazi per plotsimin dhe tejkalimin e normave ditore, ne menyre qe te perfitojne dhe t'i plotsojne ato qe deri tash nuk jane plotsue.

Veshtrisinat kryesore rrjedhin nga shkaku se katundaret nuk dashrojne me fshi me kafshe, por jane mesue me fshi me makina. Ne Kosmet, svjet, punojne disa qinda maqina fshise. Disa prej tyne jane shum te vjetra dhe shpesh here prishen, por defektet meremetohen me nji here, e katundaret punojne naten dhe diten qe t'a kryejne fshimjen sa ma pare dhe t'ia dorzojne drithin shtetit.

Kolonat e katundarve çdo dite dorzojne ma teper drith. Magazinat po mbushen, po sigurohet ushqimi i popullit punues ne qytete. Shqiptaret e Kosoves dhe te Metohis, te bashkuem me popujt e tjere te Jugosllavis dhe me anen e dorzimit te drithit kontribuojne per ndertimin e socjalizmit, frytet e te cilit i perfitojne barabarsisht. M. GJ.

Duhet me e shpejtesue punen per ndertimin e shtepijave kooperative

Gjate punave ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ puna ne ndertimin e shtepijave kooperative u-zhvillue mjaft dhe u-arrijten rezultate shum te mira. Mirepo, mbas mbarimit te Kongresit drejtorit e rretheve per ndertimin e katyne shtepijave dhe organizatat masovike ne teren fillun me e lane mbas dore ndertimin e shtepijave kooperative dhe te gjithe kujdesin e vet me ia kushtue puneve tjera ma me pak randesi. Keshtu qe ne shuma vende te punimeve te shtepijave kooperative asht u-ndalue krejtesisht puna ase punohet me shum pak puntore. Disa drejtori per ndertimin e shtepijave kooperative e justifikojne ndalimin e punes me mbrrijtjen e puneve te fushes, pastaj me ramazanin etj., mirepo, keto justifikime nuk mund t'ishin shkak, sepse per shembull ne rrethin Gjakoves asht punue ne shtepijat kooperative gjate gjithe ramazanit, e te gjithe e dijne se ky rreth ka ma teper musliman, ase per shembull ne katundin Shajkoc rrethi Podujeves asht punue gjate ramazanit nga 12 ore ne dite, me gjithse ky katund asht krejte musliman. Si shkak kryesor i ndalimit te punes asht ai se drejtorit e rretheve si dhe organizatat masovike nuk u spjegojne frontistave randesin e ndertimit te shtepijave kooperative ne katundet t'one. Ne disa vende Fronti popullor dhe keshillat e ndertimit nuk dijten me perfitue ndergjegjen politike te popujve, e cila egziston per me perforcue punen ne ndertimin e shtepijave kooperative. Si per shembull katundi Strbce ne rrethin e Ferizajt asht i njoftun me tradilat e veta luftarake dhe atdhedashes, sepse ky katund gjate okupacjonit ka qene nji nga bazat e ntra dhove partizane, e per ndertimin e shtepis kooperative ne kete katund per nxjerrjen e gurve etj., jane pague 47 mij dinare, e per fugin punonjese te pakualifikueme 38 mij dinare, qe nuk do te ngjante kurr, sikur drejtorija per ndertimin e shtepis kooperative dhe organizata e Frontit te rrethit te ishin kujdesne aq sa duhet per ndertimin e shtepis kooperative ne kete katund. Ne disa rrethe mungonte qendrueshmenija ne pune per ndertimin e shtepijave kooperative, si per shembull ne Podujeve, ku ne fillim punet zhvilloheshin ma se miri ne te tane krahinen t'one, ndersa ne kohen e fundit puna ne kete rreth ka mbetun mbrapa. Ne te gjithe vendet e punimeve te shtepijave kooperative nuk asht i sigurum materjali i duhun nga burimet lokale. Ne rrethin e Kamenices puna asht ndalue per shkak te mungeses se gurit dhe gelqeres, ne rrethin e Ferizajt ne dy vende te punimit mungojne guret, ne rrethin e Vuçiternes nuk ka gelqere, ne rrethin e Pejes nuk ka gure dhe gelqere.

Por me gjithe veshtiresinat dhe mungesat e ndryshme ne ndertimin e shtepijave kooperative jane arrijte dhe sukses te dukshme.

Mungesat, veshtiresinat dhe rezultatet e arrijtuna te permendruna ma nalte jane konstatue dhe vu ne dukje ne mbledhjen Krahinore te kryetareve te drejtorive te rretheve per ndertimin e shtepijave kooperative ne Prishtine. Ne mbarim te mbledhjes jane nxjerre konkluzionet nga te cilat jane shtrue edhe detyrat e drejtorive te rrethit per ndertimin e shtepijave kooperative per zhvillimin e punes tash e tutje. Per ndertimin e shtepijave kooperative duhet ma teper t'aktivizohen organizatat masovike, e sidomos rinija popullore. Organizatat e frontit duhet patjeter te punojne politikisht me masat popullore; sepse prej kesaj pune mvaret shum ndertimi i shtepijave kooperative. Duhet me e lidhe ma teper punen ne mes t'organizatave masovike, pushtetit popullor dhe drejtorive per ndertimin e shtepijave kooperative, me perminesue udheheqjen ne pune, e punen me e zhvillue nepermjet te njisive punuese. Njisit punuese duhet te bahen mobilizatore dhe organizatore te punes ne vendet e punimeve. Ma teper me u kujdese per mbledhjen vullnetare te ndihmes ne te holla dhe ne natyr, dhe pastaj me keto te holla me ble materjal industrijal me qellim e ndihma prej kooperativave. Veçanerisht me pase kujdes per zhdukjen e mungesat te damshem se gjoja te gjithe duhet te japin njisoj ne pune e jo simbas mundesive dhe zotsis.

Qeverija Qendrore ua ka ba te mundun kooperativave katundare dhe bujqesore te punes furnizimin me maqina bujqesore me çmime t'ulta

Ne fund te mujit qershuer, Qeverija e RFPJ ka aprovue dekretin per shitjen e maqinave te mdha dhe te mesme bujqesore, ne radhe te pare kooperativave katundare dhe bujqesore te punes me çmime t'unjisueme ma t'ulta. Ministri i Tregtis dhe i Furnizimit te Qeveris Qendrore, ne marreveshtje me Ministrin e bujqesis dhe kryetarin e komitetit per kooperativizem prane Qeveris se RFPJ-s, tash rishtas e ka prue vendimin per caktimin e maqinave bujqesore qe kane me-u konsiderue si te mdha dhe te mesme. Ministri i tregtis dhe i furnizimit te Qeveris se perbashket ka dhane udhezime per menyren e shitjes se ketyne maqinave kooperativave katundare dhe bujqesore te punes, kurse kryetari i Komitetit per kooperativizem prane Qeveris se RFPJ ka aprovue rregulloren per çfrytezimin dhe perdorimin e maqinave te mdha dhe te vogla bujqesore, te bleme nga ana e kooperativave.

Si maqina te mdha dhe te mesme bujqesore, qe ne rend te pare do t'iu shiten kooperativave, konsiderohen traktoret dhe veglat e traktorit (pllugjet, vllaqet, maqinat per tharjen e serubishtave, kultivetoret, maqinat mjellse, maqinat vet-lidhse, etj.) kombajnat, maqinat gryese, motoret mandej, pllugjet, vllaqat, cilindrat, shpernda-set e plehut arti i jal, maqinat mbjellse, maqinat kositse per bar, maqinat korrse, maqinat vet-lidhese, maqinat per nxerrjen e rrepave, maqinat fshise, elevatoret, qirueset e dores dhe me motor, maqinat heilhese, trieret, selektoret, preset e ndryshme, mullijt, preset per rrush, kazanet per alkool, sterpiloset, inkubatoret, mjetet e ndryshme per qumesht, prese per bar dore dhe me motor, pompa me motor, maqina terse per peme dhe zarzavate, dhe maqina te tjera. Sikurse dihet, kooperativave u asht ba e mundun blemja e te gjitha atyne maqinave, me perdorimin e te cilave kooperativat dhe bujqet do te mujne me i perparue ekonominat e veta, me i rrite prodhimet, dhe te cilat maqina do te kontribuojne per rekonstruimin gradual socjalist te bujqesis s'one.

Shitjen e maqinave kooperativave e kryen bashkimi i kooperativave bujqesore te rrethit me çmime t'unjisueme ma t'ulta.

Randesi te madhe ka qe keto maqina dhe mjete te çfrytezohen drejte nga ana e kooperativave bujqesore. Kooperativat ne radhe te pare do t'i çfrytezojne n'ekonominat e tyne, e mandej do t'ia apin per çfrytezim edhe atyne katundarve kooperativista, qe jane bashkue per shkak te punimit te perbashket te tokes. Maqinat do t'i çfrytezojne edhe kooperativistat e tjere, ne radhe te pare katundaret e vorfen ekonomikisht. Ata nuk kane mundesi me mjetet e tyne te furnizohen me maqina dhe vegla. Tue i çfrytezue maqinat e kooperatives, ata do t'i perparojne ekonominat e tyne, do t'a rrisin prodhimin dhe do t'a permiresojne gjendjen e tyne ekonomike. Katundaret punues do t'i çfrytezojne keto maqina. Ma perpara kete gja nuk e kane ba, sepse ne Jugosllavin e vjeter kane qene t'eksploatuem, per t'a nuk ka pase maqina dhe kurrkush nuk i ka mesue per dobin qe rrjedhe prej perdorimit te maqinave. Sot, shteti populluer iu ep maqina me anen e kooperativave te tyne, iu lene ne dispozicjon profesjonalista ekonomik dhe profesjonalista te tjere, te cilet do t'i udhezojne per menyrat perparimtare te punimit te tokes dhe per perdorimin e maqinave. Me çfrytezimin masovik te maqinave kooperative, bujqit do t'i forcojne fuqit produktive ne katund, ne radhe te pare te katundarve te vorfen dhe te mesem, e kjo asht nji nga detyret kryesore te Planit Pesvjeçar.

Tue i dhane mundesi kooperativave bujqesore per furnizimin e maqinave me çmime ma t'ulta, shteti ka krijue kushte materjale per forcimin e parkut kooperativ-mashinist prane keshillave per bujqesi. Me gjithe qe kooperativat per perdorimin e maqinave munden me e pague meditjen me te holla, me shkembim natyral etj., maqinat nuk munden me qene burim fitimi per to. Qellimi kryesor i kooperatives asht me i ndihmue katundaret kooperativista, me i ngrijte fuqit e tyne produktive me iu zgjue vetdijen per çfrytezimin e maqinave dhe per perdorim planifikit te maqinave kooperative (perveç atyne shtetnore.

Nen udheheqjen e Partis, ne baze vullnetare dhe t'aktivitetit te vet katundarve punues, do te realizohet detyra kryesore nga Plani pesvjeçar ne lamen e bujqesis, do te rritet prodhimi dhe gradualisht do te bahet transformimi socjalist ne katund. Rregullloret e Qeveris per privilegjet e kooperativave per furnizimin me maqina dhe perdorimi i drejte i ketyne maqinave ne katund, perfaqesojne nji hap perpara ne krijimin e kushteve per transformimin socjalist te bujqesis s'one.

Plani i blemjes se leshit ne krahinen t'one asht realizue me 108 per qind

Deri me 12 gusht te ketij vjeti ne Krahinen t'one asht realizue dhe tejkalue plani per blemjen e leshit. Rezultatet ma te mira jane arrijte ne rrethin e Dragashit, ku plani asht tejkalue per 30%.

Rrethi:	perqindja
Dragashit	130
Istokut	126
Prishtines	121
Prizrenit	120
Drenices	115
Gjakoves	111,8
Kamenices	108
Gilanit	108
Vuçiternes	104
Liplanit	104
Mitrovices	102,2
Podujeves	101,8
Pejes	101
Rahovecit	101
Suharekes	100
Ferizajt	99,8

Deklarim sulmuesish ne Stari Trg

Para disa ditesh ne Stari Trg asht ba deklarimi i sulmuesve, te cilet i kane plotsue kushtet e nevojshme gjate perjashtes marsqershuer, tue e tejkalue normen prej 25 — 27%. Si sulmuesa jane shpalle keta: Iviq Marko, Bubo Spasojeviq, Hamzoviq Hajrir, Azem Nebiji, Osman Miftari, Kamber Shabani Brahim Rustemi, Rustem Hamdija, Kemajl Shaqiri, Mustaf Shabani, Sejdijeviq Sheiko, Kadrijeviq Zeno dhe Avgist Bosanjak. Ndersa Qerim Arifi asht lavdue dhe asht shperbley me 500 dinare.

Nuk duhet te mbesin asnji serrnisht pa u-lavrue me njihere mbas korrjes.

Prodhimi i drithnave te bardhe ne kete vjet ka qene shum ma i mire, se kohave me vjeta e kaluem. Prodhimi ka mujte me qene edhe ma i ma dhe, sikur t'bahin krye drejte dhe me koha masat e ndryshme agro-teknike.

Nji prej shkaqeve qe prodhimi i drithnave te bardhe nuk ka qene ma i madh, ka qene bari i keq, i cili i ka pengue bimet per me u-zhvillue. Drithnat e mbushuna me kete bar nuk kane dhane prodhimin e dishruem. Ka pase raste qe ne drithna asht gjete afer 20% bar te keq. Pervec pastrimit te fares, mjeti ma i mire i luftes kunder barit te keq asht lavrimi jo i thelle i serrnishtave me nji here mbas korrjes se drithnave te bardhe. Me lavrimin jo te thelle te serrnishtave mbulohet fara e barit te keq, qe derdhet me rastin e korrjes se grurit. Kjo fare bine me njihere, por bimet e reja te ketij bari, te rrituna ne siperfaqen e tokes, per shkak te kalbes, se shkurte, nuk munden me ba fare dhe e kane prodhimin per vjetin e ardheshem e me rastin e mbjelljeve ne vjeshte ose pranvere mbulohen dhe zhduken fare.

Ne disa vende serrnishtat lehen per kullosa, sepse bujqit mendojne se me kete menyre kane ma shum dobi, se sa kur t'i kishin lavrue jo thelle me njihere mbas korrjes se drithnave. Ky mendim asht i damshem dhe duhet me e zhduke: bujqve duhet me iu tregue te mirat e lavrimit jo te thelle. Egzistojne edhe mendime te tilla se nuk asht e nevojshme me punue tash kot, me harxhue fuqi njerzore, kande djegese etj., kur kjo pune-sic mendojne disa-asht e pavlefshme. Disa thone se kane pune edhe ma te nevojshme, qe tash mundet me iu shkue dam e nuk shofin se te mbjellat pa kete pune gjithashtu shkojne dam.

Qe te zhduken keto mendime te damshme dhe te padishrueshme te disa bujqeve, duhet me iu spjegue dhe me i binde per te mirat reale te kesaj mase agro-teknike. Thyemja e serrnishtave duhet me u-krye menjihere mbas korrjes se drithnave te bardhe, keshtu te bahet e mundun qe faret e derdhuna neper ara te bijne sa ma pare. Ne rast te kundert faret do te mbesin n'are ose do te shinnojne aty dhe perseri ne vjetin e ardheshem do t'i damtojne te mbjellat t'ona. Turmave duhet me iu spjegue, me anen e konferencave, te ligjeratave te gjitha te mirat e ketij lavrimi.

Ne te gjitha keto pune, kooperativat bujqesore do t'a kene rolin kryesuer. Pran ketyne kooperativave po formohen keshillat bujqesore. Antaret e ketyne keshillave duhet me e udheheqe aksjonin e thyemjes se serrnishtave ne katundin e vet. Te mos mbetet asnji familje pa i thye serrnishtat.

Interesim apo neglizhence ne shperndamjen e shtypit t'one

Gazetat t'ona me karakter krahinuer „Rilindja", qe del rregullisht dy here ne jave-t'ejten e te djelen dhe „Jedinstvo" te djelen-bahet cmos nga ana e redaksive, qe fleturet e permenduna jo vetem te shtypen ne kohen e caktueme por edhe t'ekspedohen sa ma shpejte, ne menyre qe t'iu mbrrijne me kohe lexuesve t'one. Asht e vertete se nder te gjitha vendet e Krahines s'one, tash per tash, nuk ka mundesi qe t'iu arrijne mbrenda dites, por kjo nuk don me thane se disa qytete qendrore nuk e marrin me kohe e bile ne te njajten kohe bashke me shtypin t'one qendruer te perditshem.

Ne lidhje me kete, e pra, me shperndamjen e shtypit t'one, per te cilin jane te ngarkuem direkt jo vetem postat, por edhe librarit e Frontit p.e. ma e shpejte shperndamjes, prap, aty ketu, ende paraqiten negligjenca. Bje fjala, librarija e Frontit ne Peje me 15 gusht e ka pase terhjeke krejt shtypin tjeter dhe ka pase fillue me e shite per nji kohe bukur te mire karse „Rilindjen" dhe „Jedinstvo-n" i ka pase lane te boejne ne poste per naten e dates se siperme. Kur u pyet personeli i librarise se ka mbrrijte shtypi krahinuer pergjigjet- "doshao i proshao". Korespondenti i yne kur shkon ne poste i gjene paketat te pa-prekuna, atehere i merre dhe ia dergon libraris. Me rastin kur u pyet djaloshi gazeta-shites thu: Mos bani merak se ai qe e don vjen dhe i merre dhe ka kohe-neser do te shiten".

Interesimi i ketille nga ana e personelit te libraris ne fjale e pengon dhe e bone te flofte e pak-terheqes shtypin t'one, per te cilin Fronti i yne popullor asht tue ba perpjekje te mdha e shpenzime te duksheme qe shtypi i tij te jete ne naltesin e dukun dhe lexuesve t'iu bjen ne dore sa ma shpejte. Per sjelljet e ketilla te papergjegjeshme duhet t'iu terhiqet vrejtja negligjaseve dhe te merren masa per mos perseritjen e tyne.

N. B.

Hapja e bibliotekes shqipe ne Prishtine

Me inisjativen e keshillit te qytetit, para disa ditesh asht hape biblioteka me libra shqipe.

Pushteti Popullor po i ep te gjitha ndihmat materjale per organizimin e kesaj biblioteke, ne te cilen masat shqiptare te qytetit do te perfitojne mjaftie per ngritjen e tyne kulturale. Ne kete biblioteke lexuesit shqiptare do te gjejne libra politike, shoqnore dhe kulturale si dhe koleksjone gazetash dhe revistash.

Edhe me kete provohet, se, na shqiptaret e krahines se Kosmetit i gezojme, pervec te drejtave tjera barabarsisht me popujt tjere, dhe ato kulturale ne Jugoslavin e re, dhe qe te gjitha ne saje t'udheheqsis se drejte e t'urte te Partis s'one Komuniste, ne krye me shokun Tito.

Pushteti Popullor i qytetit ka dhurue 000 cope libra. Keshilli i saje i fton te gjithe intelektualet shqiptar te qytetit qe ta ndihmojne bibliotekon me libra shqipe rreth mundesive qe kane, ne menyre qe kjo te pasunohet sa ma teper dhe t'u bahet e mundshme te gjithve me studjue, me perfitue nga librat e ndryshme ,te cilat nuk mund t'i kete askush komplet.

Lokali i bibliotekes asht vendose ne rrugen Marshall Tito.

XH. Rexha

Fiskultura dhe Sporti

Rezultatet e fot-ballit te turneut te dyte

Metohija - Vllaznija 1:0

Prishtine

Kete te djele ne fushen sportive u-zhvillue ndeshja ndermjet te shoqnis sportive „Metohija" prej Prizrenit dhe te „Vllaznija" nga Prishtina. Gjate ketij kompionati kjo ndeshje ka qene ma e persosun deri me tash. Shiqesit kane mbete shum te kenaqun. Loja ka qene e gjalle dhe interesante. Rezultati 1:0 ne favor te Metohis nuk i pergjigjet lojes. Per te pase fotografin e drejte te lojes ma se miri kishte me u pergjegje perfundimi asnjanes. Skuadra e „Vllaznis" e perbame prej lojtarve te rij ka perspektiva per zhvillim.

Zhelezniçar - Hylli i kuq 1:1

Prishtine

Edhe keto dy skuadrat u-ndeshen ne fushen sportive te Prishtines. Loja ka qene se kah ta marrish e keqe, e rande, pa kurriare sistemi. Kane lane pershtypje se te dy palet perpara se me u paraqite ne fushe te kene vendose „me fitue pa tjeter e me çdo kusht". Nji qendrim i ketille asht per çdo kritike. Arbitri nuk ka qene shpesh here i vendosun, perçka kane ndodhun raste skjarimi ndermjet lojtarve. Loja perfundoi 1:1.

Radniçki - Borac 1:6

Voçiterne

Loja ndermjet te ketyne dy skuadrave ka qene mjaft e dekun ndoshta kjo ka rrjedhun per shkak te rezultatit te nalte ne favor te shoqnis Borac, porse asht edhe fakt se portjeri i Radniçkit i ka fale kundershtarit 4 gola te mira. Organizimi i ndeshjes ka qene i mire.

Ardhemenija - Kaçusha 2:0

Peje:

Per te djelen kane pase me luejte Ardhmenija e Pejes me Kaçushen e Kurshumlis, mirpo skuadra mike nuk erdhi ne diten e caktueme, prandaj loja u-zhvillue te hanen. Me gjithse dite pune ka pase publik te mjaftueshem. Pejanet kane dhane nji loje te bukur e po thuej se krejt lojen e kane pase ne doren e tyne. Te dy golat per Ardhmenin i shenoi D. Babarogiq.

Sloga - Polet

Liplane:

Gjate aktivitetit sportiv ne kete vjet per te paren here ne Liplane u- zhvillue ndeshja perfundimtare ndermjet te ketyne dy skuadrave. Loja ka qene me te vertete e shpejte dhe e gjalle. Topi ka shkue shpesh here sa prej nji porte ne tjetren. Loja ka qene korrekte nga ana e lojtarve por fatkeqsisht publiku e ka pengue zhvillimin e saje, tue u futun shum here ne terenin e lojes, perçka arbitri ka qene i shtrenguem me e pezullue 17 minuta perpara se te perfundoj. Me gjithse arbitri iu drejtue disa here keshilli sportiv te shoqnis „Sloga", qe te vendosi rregullin, por ai nuk u pergjegje thirrjes se tij, prandaj pezullimi ka qene me vend e i drejte. Loja asht pre 3:2 ne favor te Sloges.

—o—

Prishtine:

Keshilli i foot-ballit te bashkimit fiskultural per Kosmet ne mbledhjen e tij, me rastin e ankimit te shoqnis „Zhelezniçar" vendosi qe ndeshja e luejtun me 8 te k. m. ndermjet Zhelezniça-rit (Fushe-Kosoves) e te Hyllit te Kuq (Gilanit) t'anulohet dhe ndeshja te perseritet ne nji teren te ri e neutral me 19 gusht ne Ferizaj.

Po ne kete mbledhje u- vendos qe loja e pezullueme ndermjet te skuadrave te shoqnive Sloga e Polet te perseritet ne terenin neutral te Mitrovices per aq kohe sa nuk asht luejte.

N. Begolli

Kooperativa e kepuctarve te Gjakoves ka formue aktivin fiskultural

Me inisjative e keshillit gjimnastikuer te rrethit te Gjakoves me date 8-VIII-1948, u-mbajte konferenca e nendeges sindikale te kooperatives se kepuctarve. Ne ket konference mbas fjalimeve te sekretarit te keshillit gjimnastikuer te rrethit, i cili tregoi randesin e zhvillimit te fiskultures ndermjet puntorve, u formue aktivi i fiskultures ne ket kooperative. Ne ket aktiv u regjistruen 45 antare te kooperatives. Mbas kesaj u-zgjodhe dhe udheheqesija e aktivit, e cila per puntoi planin e punes ne ket aktiv.

G. R.

Nga Bashkimi Sovjetik

BRSS - vend me bujqesi te perparueme

(Vijon nga numri 136)

Me ane te maqinave katundi sovjetik ka mbrri, per nji kohe te shkurte me i zhduke mjerimet e shumta, qe, per dheta vjetesh po e shtrengojshin katundarin. Çashtjen e mjerimit ma te madh qe po e shtrengonte katundarin e zanne me goje ma pare; ai ka qene skllav. Qe, ky ka qene mjerimi i tmerrshem i katundarit rus. Sot kolhozniket nuk dijne per kete mjerim. Vendit te dikurshem te qiflligarve, te cucli, kuvendeve dhe kullakve, qe nji here e pergjithmone ka hye ne kolhoz, keta i kane shtue siperfaqe tjera ekonomitash. Me traktora jane thye ledinat. Shum moçale jane tha. Jane çele zabele. Katundi ka shtue token e pjellshme shum ma teper. Ne vjetin 1935 ne kolhoz, ne rejonin e Vurnarskut te RASS te Çuvagut, i cili kolhoz mban emnin e Stalinit, ka pase 644 ha toke. Per dhete vjetet e fundit kolhozi e ka zgjanue ket siperfaqe deri ne 767 ha.

E tane siperfaqja e tokes qe mbillet ne BRSS, ne vjetin 1938 ka mbrrijte 136,9% miljona hektare, ne krahasim me 105 miljona ha. ne Rusin e vjeter, ne vjetin 1913.

Rusija para-revolucjonare nuk ka dijte per industrin e traktoravve. Ajo nuk e ka pase industrin kimike. Katundari nuk ka dijte per plehun kimik, as qe e ka perdore ne token e vet.

Ne Bashkimin Sovjetik industrija kimike asht nji nga deget ma me randesi e bujqesis. Ajo ka randesi te madhe ne lufte per shtimin e pjellshmenis se tokes, per frytin e madh.

Katundi sovjetik po e ban ket lufte ne bashkepunim te ngushte me shkencen. Katundi i dikurshem nuk ka dijte per agronama. I tane nji rreth e ka pase vetem nji agronom. Natyrisht ky nuk ka mujte me ndikue ne fatin e bujqesis, pervec kesaj, me kush te te nji ekonomije te vogel katundare shkenca agronomike si dhe maqina kane qene nji luks i paarritshem. Bujqesija asht mbajte, tue u mbeshtete ne pervojen e gjysheve. Ajo asht mvare prej fuqive te lira te natyres. Katundari pritte bekimin e Zotit. Ky, ne lufte kundra natyres ka qene vetem. Ne kete lufte shteti s'ia ka ngjite doren.

Prioriteti i ekonomis se madhe socjaliste qendron ne faktin se ajo punohet ne baza shkencore. Ne bujqesi punojne me dheta mije ekspertash. Ne kolhoz ka mbrri agronomi dhe veterinari. Por, puna nuk asht vetem te keta. Shkencen agronomike, agroteknike e kane pervehtesue edhe shum katundare. Bashke me shtimin e pergjithshem t'arsimit dhe nder katundet sovjetike po perhapet edhe dija agronomike e banoreve te tyne.

Kolhozjani dhe kolhozjanje jane katundare te tipit te ri. Kesi katundaresh ne Rusin e vjeter nuk ka pase, as qe ka mujte me pase. Katundaret sovjetik dijne me çmue dijtunin. Ata rezultatet e shkences i shtin ne perdorim ne punen e tyne praktike. Kultura e punimit te tokes asht ngrite.

Ne kulturen e bujqesis qendron garantii i perfundimeve te mira, te ma vona te katundit kolhozjan.

„Na duhet-ka thane Kalinini - me ngrehe nalte bujqesin t'one, me e ba sa ma teper te pileshme, tue ruejte njikohesisht edhe fuqin njerzore dhe tue ndihmue ngritjen dhe shpirtin krijues te kolhozjaneve.

Nuk asht larg ajo dite kur te gjithe te rijt si nder qytete, ashtu edhe nder katunde do t'a kene te kryem arsimin e mesem-atherhe nuk do te kete bujqesija ndonji pengese, atherhe nuk do t'i pengojne aftesit e njerzeve per pune, te cilet edhe mbasi t'a kene krye shkollen e mesme do te dishrojne me punue ne kolhoz?

Jo nuk do te pengojne. Por nuk mjafton me thane vetem „jo". Vet fakti qe ne t'ardhmen do te shtypin ti njerzit, te cilet e kane krye shkollen e mesme, do te lavrojne njerzit me kulture te mesme,-do te thote pelvetiu se keto pune duhet, te themi, te kulturohen".

Bujqesija ne BRSS asht tue perparue gjithnji. Deri edhe gjate luftes, shum kolhoze dhe sovhoze, jo vetem qe s'e kane ule shkallen e ekonomis prodhueshmenin e saje, por edhe e kane ngre bukur mire. Gjate luftes jane dalue posaçerisht virtytet ma te mira te katundarve sovjetike, dashunija e tyne ndaj punes, durimi dhe qendrimi i tyne, dijen dhe talentin e tyne per pune e kane tregue ne mbrrijtjen e shum perfundimeve ne bujeqsi. Qe, tjala vjen çfare rezultatesh te dukshme kane mbrijte antaret e kooperatives bujqesore: Katundi sovjetik ne reonin e Bogorodit, ne krahinen e Gorkit. Ne vjetin 1940 ata kane mjerre 18,6% centi drith per çdo hektar. Ne vjetin 1944, ata kane mbrrijte me nxjerre 22,6% centi drith prej nji hektari. Jane interesante dhe disa fakte tjera qe kane ndodhe ne te njajtin kolhoz. Para kolektivizmit, ekonomija e katundari Birin ka prodhue 36,1% pudi drith per çdo puntuer t'afte pune, ne vjet, karse ekonomija e Djominit nga 56,5% pudi per krye. Ne vjetin 1940 asht prodhue nga 117,6% pudi drith, per çdo kolhoznik t'afte, per pune, ne vjetin 1944 vjet lufte asht prodhue proporcjonalisht nga 121,2% pudi drith per krye.

Si ne shembullin e nji kolhozi ashtu edhe ne shembullin e nji katundi kolhozjan, shihet kjartas se kolektivizmi i ekonomive te mdha socjaliste asht sistemi ma i dobishmi, ma frytedhanesi, ma perparimtari.

Ka edhe nji gja me randesi te madhe ne katundin sovjetik: Ekonomija e kolhozit mbarshtrohet me plan.

Ky fakt flet mbi epersin e madhe te sistemit socjalist mbi ate kapitalist.

Populli sovjetik, mbasi e perfundoi luften triumfalisht, ia ka hye prap ndertimit paqesuer te socjalizmit edhe po marshon ne rrugen e komunizmit. Puntoret dhe katundaret, me energji te dyfishueme po luftojne per plotesimin e Planit te ri pesevjeçar. Realizimi i ketij plani do t'a ngrehi bujqesin sovjetike ne nji shkalle te re.

Ne vjetet ma t'aferme do te perplotesohet parku i maqinave. Katundi do te marri plehe kimik ma teper. Shkenca sovjetike i mobilizon fuqit e veta per me u ardhe ne ndihme katundarve.

Katundaret sovjetike kane fitue per veje shum te madhe. Ata jane mesue me i çfrytezue epersit e menyres socjaliste te mbareshtrimit t'ekonomi. Ata e kane zotnue traktorin dhe kombajnin. Vullneti, puna dhe dija e tyne do t'a forcoje edhe ma teper fuqin ekonomike dhe ushtarake te shtetit sovjetik, lulezimin e bujqesis, e punuesve shtetnore, kolhozat e mireqenjen individuale te kolhozjanve.

Katundi Isniq shembull per ndertim ne rrethin e Pejes

Banoret e katundit Isniq te rrethit te Pejes porsa kane qene te njoftuem se gjate ketij viti ne Krahinen t'one do te ndertohen shtepijat kooperative me entuziazem iu pergjigjen thirrjes. Me nji here i bane te gjitha pregatitjet e nevojshme si te materjalit lokal ashtu edhe te landve kryesore. Mbrenda nji kohe shum te shkurte me inisjative te tyne e gjeten nji numer te mjaftueshem te mjeshtreve per te fillue muratimin e nderteses.

Katundaret e ketij katundi porsa muerren vesht detyrimet qe merrte populli i jone punues per nderë te Kongresit te Peste te PKJ-s e ndijten per detyre edhe ata, qe te çfaqin dashiren e tyne se jane te gatshem me dhane gjithshka per ndertimin sa ma te shpejte te socjalizmit ne Vendin t'one. Prandej ne garat sulmuese te para Kongresit njizani kane pase vendosun qe deri me 21 korrik me e krye shtepin e kooperatives. Atehere, per mos me dalun fjal'et dhe per mos me lane mbrapa punen e fushes, keta e zgjidhen problemin e' fuqis tue i kushtue kooperatives disa ore te mira edhe te nates. Keshtu me kete vetmohim e bind'je te plote ne fuqit e tyne, punen ashtu si s'mbajne mend as pleqet qe te jete punue ndonji here ne katundin e tyne. E me te vertete ne kohen e caktueme shtepija kooperative e llojit te IV ka qene e kryeme.

Keta nuk mbeten te knaqun me kaq dhe as qe u dehen prej suksesit te korrun gjate garave, perkundrazi vazhduen po me at hov punë, por tash ne nji objekt tjeter, n'objektin e gjimnazit, i cili ka pase mbetun i pa kryem prej vjetit te kaluem. Pregatiten shumen e nevojshme te tullave prej 60.000 copash, landet e duhuna i kane pre dhe ma se gjysen i kane bajte ne vendet e punimeve, kane pjeke nji furre gelqereje dhe nji tjeter e kane pregatitun, njikohsisht e kane sigurue materjalin si hekur, cimentë e dërrasa.

Isniqasit kane dhane premtimin se deri ne fund te muejit shtatuer kane me i krye te gjitha punimet rreth gjimnazit, keshtu, qe, per fillimin e vjetit shkolluer te kene mundesi me i ndjeke mesimet jo vetem femijet e tyne por edhe femijte e katundeve t'aferme. Me punen e tyne intensive e te palodhshme ata e stolisin katundin e tyne me dy ndertesa madheshtore, tue i dhane shembull katundeve te tjera te rrethit te Pejes.

N. Begolli

Perhapesit e lajmeve tedencioze perpara gjyqit te populit

Njerez, anmiq te popullit, te cilet deshrojne me peshkue n'ujin e turbull e, qe ende shpresojne se mund te kthehet prap e vjetra, nuk lane shteg pa e hape gojen e tyne te helmatisun per me vjelle parolla te ndryshme me qellim qe te dizorientojne popullin.

Te ketille kane qene ne Gjakove Ramiz Kpuska dhe Zhivko Janiçeviq, te cilet me koshjence kane perhape lajme te rrejshme.

Keta jane njerez te njoftun per ndjenjat e tyne kundra pushtetit t'one populluer sikurse asht Zhivko Janiçeviq i cili ne kohen e okupacjonit ka bashkepunue me tradhtarin me damke Beqir Malokun tue spijunue kundra luftareve t'one, si dhe Ramiz Kpuska i cili ka ba furren e tij qender njerezish te pakenaqun e te prekun nga reformat e pushtetit t'one.

N'akuzat e tij prokurori i popullit i çfaqi ma se miri qellimet e poshtra te parollave te ketilla, dhe na i paraqiti si duhet fytyrat e fillqta te tyne. Kete e pa vete populli i Gjakoves dilen e gjyqit, me daten 11 te ketij muaji i cili mbushte sallen plotepla se kulturës.

Te pandehunit tue u-munduе, "si pule e lagun" me iu ike akuzave dojshin me mbulue fajet e tyne te faktueme, por dora e drejtesis se popullit ...

Gjykimi ne Gjakove te vleje si shembull per te gjithe ata qe kerkojne me shkaput popullin nga pushteti i tij, nga puna dhe nga paqa e tij. (T. H.)

Nga situata nderkombtare

Memorandumi Jugosllav para keshillit te sigurimit

Teksti i rezolutes, qe ia ka propozue keshillit te sigurimit dr. Vilfan-perfaqesues i RFPJ

New-York.

Korespondenti i Tanjugut lajmeron:

Ne mbledhjen e dates 14 te k.m. te Keshillit te Sigurimit, ne te cilen asht vazhdue shqyrtimi i memorandumit Jugosllav per çashtjen e Triestes, delegati i Jugosllavis Dr. Jozhe Vilfan propozoi kete rezolucjon:

"Mbasi art. 21 i traktatit te paqes me Italin parashef qe Teritori i lire i Trieshtes asht njohte nga ana e fuqive, te kombeve te bashkueme dhe t'Italis, te cilat jane pajtue qe integriteti dhe pamvarsija e tij te garantohen nga ana e Keshillit te Sigurimit, mbasi art. 21, kapitulli i 3—te, i traktatit te paqes me Italin parashef qe mbas heqjes t'afatit te sovranitetit italjan, Teritori i Lire i Trieshtes do te qeveriset ne konformitet me dokumentet mbi rregjimin e perkohshem te pranuem nga ana e Keshillit te ministrave te puneve te jashtme dhe te aprovuem nga ana e Keshillit te Sigurimit.

Keshilli i Sigurimit, tue i shqyrtue ahuzat e Qeveris se Jugosllavis te paraqitueme para Keshillit te Sigurimit ne lidhje me nji varg traktatesh te dates 9 mars dhe 16 prill te vitit 1948 dhe ne lidhje me marreveshtjen postare te lidhun ne mes te pushtetit ushtarak aleat dhe Italis, vendose qe traktatet e permendura jane ne kundershtim te plote me obligimet qe i kane ndermarre aleatet, Kombet e bashkueme dhe Italija ne baze t'artikullit 21 te traktatit mbi paqen me Italin dhe ne baze te dispozitave nga anekset, qe jane pjese perbase e traktatit mbi paqen.

Keshilli i sigurimit deklaron se traktatet e 9 marsit te lidhun ne mes te Pushtetit ushtarak aleat dhe Italis, si edhe traktatet e 16 prillit te vitit 1948, qe bajne fjale per plotsimin e traktatit e 9 marsit si edhe marreveshtja postale, jane ne kundershtim me statutin e Teritorit te Lire te Trieshtes dhe prandaj shpallen si te pavlefshme. Keshilli i Sigurimit i thirre qeverit e SH.B.A. dhe te Britanis se Madhe me e marre ne dijeni kete rezolute dhe ne t'ardheshme me iu largue çdo procedure qe nuk pajtohet me rregulloret e Traktatit mbi paqen me Italin".

New-York.

New-York Tajms" shpalle lajmin e korrespondentit te vet nga Istambolli me titull "Ne Turqi plani i Marshallit ndeshe ne kritike gjithnji ma te madhe". Ne lajmin theksohet se Partija e zhvillueme kombetare turke e ka kritikue shum ashper marreveshtjen bilaterale amerikano-turke. Ne kritike theksohet se ky traktat "do ta shkatrron eksportimin turk dhe katundarin turke". Fletorja shton se-simbas pikpamjeve te vrojtesve-kjo kritike dhe sulmet e shpeshta ne politiken e pergjithshme te Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ne Turqi do t'i tronditë edhe keshtu pozitat e gerrmueme te qeveris turke, e cila ne pikpamje te zgjidhjes se çashtjeve kryesore te jashtme mvaret prej SHBA-s".

—o—

Qeverija e Atines pregadite me i akuzue rrejshem fqijt verior te Greçis

Athine.

Radio stacioni i Greqis se lire shpalle komentin me rastin e krizes ma te re te qeverija n'Athine, ne te cilin i demaskon qellimet e vertete t'okupuesave anglo-amerikane, ne duer e te cileve gjindet fati i çdo qeverije t'Athines.

„Mbasi edhe zavendesi i Sofulit ne Partija liberale, Venizeloi asht shprehe kunder koalicionit te tashem te qeveris-thohet ne koment- triumviriati amerikan n'Athine, ambasadori Grejdi, Nuvini dhe gjenerali Van Fiit kerkojne arna te reja per qeverin e Athines, keshtu qe tash te bisedohet mbi ministrat e ri "jasht Partije" Grofin Gjovani Tetokija dhe per antarin e Metaksasit-Sacelerin. „Arnat" e reja per qeverin e Athines jane te nevojshme mbas nji vargu te deshtimeve ne frontin e Gramosit e edhe per mbledhjet e ardhshme te Kombeve te bashkueme. Deshtimet n'operacionet kunder Armates demokratike i kane detyrue mercenaret dhe agentat anglo-amerikan ne Greqi me e perforcue aktivitetin provokues kunder fqinjve te Greqis. Mbasi i kane mobilizue te gjitha fuqit e tyne per me trillue kush e di se çfare dokumentash te rrejshme, ata pregatiten qe ne mbledhjen e ardhshme t'Asamblees gjenerale te Kombeve te bashkueme t'i akuzojne ne menyre provokuese fqijet e Greqis, qe gjoja jane fajtore per shkak te mos-suksesit te tyne ne Gramos. Mercenaret e Athines i trillojne veçanerisht "shenimet" qe Armata demokratike ka bajte gjoja kundra monarkofashistave nga teritori i Shqipnis. Ne realitet, gjithkush e dan mire se bash monarkofashistat ne nji varg rastesh i kane dhanun kufijve e Shqipnis me qellim ngjarjesh t'incidenteve dhe konfliktave.

Te gjitha keto manevra-thohet ne fund te komentit-kane per qellim me i mshefe humbjet e monarkofashistave, te cilet qe plot dy muej pesojne ne Gramos dhe nga ana tjeter me e pregadite terenin per aksione te reja avanturiste te sherbetoreve Athinas nen kontrollin e Zotnijve amerikan. (Tanjug)

Ndihmesi i atasheut detar te Sh. B. A ne Moske asht kape ne veper spijunazhi

Ne baze te kerkeses se ministris se puneve te jashtme te BRSS togeri Drejer asht dasht me te shpejte me e lane Bashkimin Sovjetik

Moske.

Agjencija TASS lajmeron:

Nen titullin „Shpijuni amerikan asht kape ne veper" fletorja „Pravda" e shpalle kete lajme:

Si, asht informue korespondenti i „Pravdes", para disa muejve organet kompetente ne nji prej limaneve jugore te Bashkimit Sovjetik kane hetue se nji prej nepunsave te doganes se vendit mbledhe lajme ushtarake ne kohe mbas kohe shkon ne Moske. Ai asht vne ne survejim. Tash s'afermi ai persri ka shkue ne Moske. Me 23 prill te ketij vjeti ne moske asht takue me nji person te pa njoftun, te veshun ne rrobe civile dhe bashke me te ka shkue ne nji dhome te doganes, ne te cilen n'ate kohe nuk ka qene kurkush. Diçka ma vone n'ate dhome ka hye nji perfaqsues i sherbimit te rojes bashke me nepunsin e doganes se Moskes.

Kur e kane diktue perfaqsuesin e sherbimit te rojes dhe nepunsin e doganes se Moskes personat qe kane qene rreth tavolines — punusi i permendun i doganes nen survejim dhe shoku i tij me te shpejte kane fillue me i mshehe disa letra dhe shenime. Perfaqsuesi i sherbimit te rojes i ka urdhnue me i tregue letrat dhe shenimet dhe ua ka marre nga tavolina disa tabak letër, qe nuk kane mujte me i mshefe. Atehere personi i pa njoftun ne rrobe civile asht perpjeke me ia nxjerre letrat nga dora perfaqsuesit te sherbimit te rojes dhe ka fillue me i ra. Kur nuk ka mujte me ia kape letrat, ai ka fillue me i shkye ne copa t'imta shenimet qe i ka pase para vedit.

Asht vertetue se blloku i shenimeve i nepunsit te doganes ka permbajte ne nji mase te madhe lajme sekrete ushtarake dhe se letrat e tjera kane permbajte shenime te hollsishme mbi lajmet e njejta ne gjuhen angleze. Asht konstatue se personi i pa njoftun ne rrobe civile asht ndihmesi i atasheut detare te shteteve te Bashkueme t'Amerikes, togeri Robert Drejeri. Nepunesi E. i doganes i cili i ka dhane lajme ushtarake sekrete Drejerit ka deklarue: „Mbasi u zuna ne veper duhet te pranoi qe kame mbledhe dhe dhane lajme shpijunazhi Drejerit, simbas urdhnit te tij. Shenimet qe jane marre prej meje permbajne listen e lajmeve sekrete qe i kame mbledhe dhe dhane Drejerit sot. Mbledhja e jone e ma parshme asht mbajte ne Moske ne kalleuer te kesaj vjeti, kur gjithashtu i kame dorzue Drejerit lajme sekrete per çashtje ushtarake". Togeri Drejer nga ana e tij ka deklarue: „Vertetoj qe prej E. kam marre lajme sekrete, te cilat i kame fute personalisht ne fletore t'emne te shenimit. Ne kallnuer te ketij viti jam takue me te ne dogane dhe gjithashtu prej tij kam marre lajme sekrete". Ambasada e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes ne Moske asht lajmrue se ndihmesi i atasheut detare asht kape ne veprim shpijunazhi. Faktet kane qene aq te pa mohueshme sa qe Ambasada as nuk asht perpjeke me i demantue dhe pa kurrfare kundershtimesh ju ka binde kerkeses se ministris se puneve te jashtme te BRSS qe togeri Drejer te largohet me te shpejte nga Bashkimi Sovjetik.

Armata Demokratike e Greqis se lire me sukses i kundershton sulmet e monarkofashistave

Athine.

Radio stacioni i Greqis se lire lajmeron se mbas sulmeve te pasuksesshme t'ushtris monarko-fashiste, ne sektoret e frontit ne Pindosin Verior asht ndalue lufta. Simbas lajmeve plotesuese per luftat ne diten 13 gusht monarkofashistat kane pase edhe 25 te vdekun dhe 35 te plagosun, keshtu qe humbjet e pergjithshme t'anmikut n'ate dite kane qene 156 te vdekun e 405 te plagosun. Simbas lajmeve te mavonshme per luftat ne Thesali anmiku ne luftat ne rrethin Kalambakdhe neper brigjet per rreth ka pase 48 te vdekun dhe 115 te plagosun. Ne keto operacione anmiku ka pase edhe dame te medhaja materijale.

Njisite e Armates demokratike kane sulmue ne kampin e fortifikuem t'anmikut Ni-kant, ne veri te vendit Nurgane dhe e kane thye plotesisht garnizonin e atjeshem t'anmikut. Anmiku ka pase 30 te vdekun dhe te plagosun. Asht zane nji numer i madh pushkesh, i gjanave ushqimore dhe materijal tjeter.

N'Epir njisite e Armates demokratike, qe bajne operacione ne malesinat Valjanida, e kane mbrapsue sulmin e batalonit 603 monarkofashist dhe kane kalue ne kundrasulm. Asht thye batalioni i anmikut dhe jane zane sasina te shumta te materjalit luftarak.

Lufta çlirimtare e popujve te Kines

Fronti i Kines Qendrore.

Ne luftat ne Veri prej qytetit Nanvanga, kryqezim i randesishem rrugesh ne Honanin Juguer, Armata nacional-çlirimtare i ka vra, plagose ose zane rob me 18 korrik, 2000 ushtare te divizionit te nande te riorganizuem te Kuomintangut. Jane zane 20 topa si edhe sasina te ndryshme te materijalit luftarak.

—o—

Fronti i Shansit Qendror.

Simbas lajmeve nga fronti ne Shansin Qendror, ma teper se 1000 ushtare te Kuomintangut i jane dorezue me 20 korrik Armates nacional-çlirimtare afer nyjes hekurudhore Kijesh, ne Jug-prendim te Tajuanit. Ata i kane dorezue komandes se trupeve naciona-çlirimtare 100 topa, 1000 pushke e revolvera dhe sasina te shumta municioni. Ne fillim t'ofanzives ne Shansin Qendror edhe 1000 ushtare dhe oficera te Komintangut jane dorezue dhe kane hye ne rradhet e Armates nacional-çlirimtare.

Shpesh here ngjane qe rradhe te mira te trupave te Çang Kaj Shekut t'i dorezohen grupeve te vogla te vullnetareve t'Armetas nacional-çlirimtare. Ne rrethin Femijeng, nji rradhe e vogel e katundareve t'armatosun i ka zane rob 175 ushtare dhe oficera te Komintangut dhe me kete rast i ka zane disa topa, 3 mitraloza dhe 34 pushke. Ne qytetin per rreth Kijao Çeng, katundaret nga rrethi dita per dit ia dorezojne pushtetit ushtaret dhe oficerat e Kuomintangut dhe arme anmike, qe i kane zane rob.

—o—

Singapur

Agjensija Rojter lajmeron:

Tyror'i pergjithshem i organeve te pushtetit kolonjal britanik dita per dite po zgjanohet gjithnji ma teper, i cili me çdo kushti deshron me e shue levizjen nacional-çlirimtare te popullit te Malajes.

Simbas lajmeve te Rojterit, ne Kuala Lampur jane vrare pese Malajasit e pare, te cilet jane denue me vdekje nga ana e organeve te pushtetit kolonjal ne baze te ligjeve mbi gjendjen e jashtzakonshme ne Malaje.

SHPALLJE

Sipermarrja Krahinore e shtypit dhe e botimeve e Keshillit Krahinuer te Frontit populluer

„MILADIN POPOVIQ"

i njoftan te gjitha organizatat masovike, institutet, sipermarrjet dhe individet se, perveç botimit te gazetave revistave, broshurave dhe librave, pranon porosina per formulare te ndryshem dhe per te gjitha llojet e pasqyrzave tabelare ne gjuhen serbokroate dhe shqipe

Sipermarrja ka ne posedim cinkografine per punimin e klisheve.

Porosinat me i dergue ne ket adrese:

SIPERMARRJA E SHTYPIT DHE E BOTIMEVE „MILADIN POPOVIQ"

PRISHTINE, TELEFON 123

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miladin Popoviq", Prishtine.
Pajtimet ne fletoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.